



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Cërrik, me 21.09.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Sherbimi i internetit ne Bashkine Cerrik- marreveshje kuader me nje operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet e internetit 72400000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 8500000 (*tete milion e peseqind mije*) leke pa tvsh .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Cërrik ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e ofertës.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kushteve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare, 2020,2021 dhe 2022, ku vlere e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me vogel se 40% e vleres se fondit limit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i vleres së kërkuar argumentohet si me poshte:

Duke marre ne konsiderate veren e fondit limit te kesaj procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike he financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara.

Percaktimi i viteve te kerkuara per paragjitjen e vërtetimit te xhiros vjetore eshte bërë ne zbatim te Ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" , i ndryshuar, Udhëzimit te Ministrit te Financave Nr. 5, date 30.01.2006, "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, VKM-se Nr. 922 date 29. 12.2014 "Per deklarimin e detyrueshem te deklaratave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike", si dhe kerkesave te Ligit Nr. 25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021 dhe 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme te ngjashme, te kryera gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 40% te vleres se fondit limit te perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmit e meposhtme:

- a) Per pervojen e meparshme te realizuar ne sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen

vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe faturave tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

- b) Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar ne sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat iso të vlefshme si me poshte :

- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikaten Iso 9001:2015 ose ekuivalente të vlefshme mbi “ Sistemin e menaxhimit të cilësive” .
- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikaten ISO/IC 20000-1:2018 ose ekuivalente të vlefshme mbi “ Sistemin e menaxhimit të shërbimit”
- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikaten ISO/IC 27001:2017 ose ekuivalente të vlefshme mbi “ Sigurime të informacionit”
- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikaten ISO/IC 14001:2015 ose ekuivalente mbi “ Certifikimi i sistemit të menaxhimit mjedisor”.
- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikaten Pas 99: 2012 ose ekuivalente të vlefshme mbi “ Certifikimi i sistemit të menaxhimit të integruar”.

Certifikatat e mesiperme duhet të jene të leshuara nga një organ i konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë përcaktuar bazuar në nenet 77 dhe 79 të LPP, të ligjit nr. 162/2020, datë 23. 12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontrate. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontrates në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontrate. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontrates.

Përmbushja e standartit ISO 2000-1 është thelbësore pasi nëpërmjet këtij certifikimi, Operatori Ekonomik duhet të demonstrojë si ofruar shërbime aftësi për të planifikuar, implementuar, operuar, monitoruar rishikuar dhe përmirësuar shërbimet e ofruara. Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontrates janë sipas standarteve ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

Permbushja e standartit EN ISO 14001:2015 Specifikon kerkesat per nje sistem te menaxhimit mjedisor qe nje organizate mund te perdor per te permiresuar performancen e saj mjedisore. Operatori ekonomik kerkon te menaxhoj pergjegjësité e saj mjedisore ne nje menyre sistematike qe kontribuon ne shtyllën medisore te qëndrueshmërisë.

Permbushja e standartit BS PAS 99:2012: Percakton kerkesat e perbashketa te sistemit te menaxhimit(MS) dhe synohet te perdoret si kornize per zbatimin e dy ose me shume standarteve te sistemit te menaxhimit (MSS) ne nje menyre te integruar nepërmjet ketij çertifikimi, Operatori Ekonomik projekton dhe implementon, realizon asistenca dhe suport teknik mbi sistemet teknologjike, informatike dhe te komunikimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete jo me pak se 15 “Peer” (sipas Ripe NCC) si dhe te kete te pakten 2 “Peer: me dy as te regjistruar jashte territorit te Shqiperise te vertetuar me kontrate.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme jane te rendesishme per te garantuar disponueshmerine dhe qendrueshmerine e sherbimit te aksesit internetit, si dhe ofrojne siguri dhe stabilitet te sherbimit te Internetit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi kualifikimi te sigurimit teknik per stafin e tij per minimalisht 7 punonjes, per te vertetuar kete, operatori ekonomik duhet te paraqese listepagesat e tre muajve te fundit te shoqeruar me deshmite perkatese te leshuar nga organet zyrtare te certifikimit teknik – Certifikate per sigurimin teknik elektrik.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit 18 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe ne nenin nr. 41, pika 4, germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021

"Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te kerij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne që kanë personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Numri i punonjesve eshte percaktuar bazuar ne natyren e sherbimit dhe shperndarjen gjeografike te pikave ku do te ofrohet sherbimi.

Operatoret ekonomike duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për te zbatuar kontraten.

2.3.5 Operatori ekonomik per zbatimin e kontrates duhet te kete te punesuar ne stafin e tij jo me pak se 22 (njetete e dy) punonjes te diplomuar ne fushen e telekomunikacionit, elektronike, informatike, teknologji informacioni dhe/ ose elektrike, te vertetuar kjo me formularin E-sig te listepagesave per 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Ne baze te pikës 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te këtij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te objektit te prokurimit dhe/ose komponentet e tij.

2.3.6 Operatori ekonomik per zbatimin e kontrates duhet te kete te punësuar ne stafin e tij jo me pak se:

- 7 Inxhinierë me Certifikate MTCNA ose Ekuivalente
- 3 Inxhinierë me Certifikate MTCRE ose Ekuivalente
- 1 Inxhinier me Certifikate MTCSE ose Ekuivalente

Argumentimi: Ne baze te pikës 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te këtij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te objektit te prokurimit dhe/ose komponentet e tij.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje structure Helpdesk te dedikuar, te kontaktueshem 24/7/365 .

Per permbushjen e ketij kriteri oe duhet te paraqese vetedeklarim.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te ofroj support local ne te gjitha pikat e shenuara ne tabelen e pergjithshme per te garantuar maksimumin e cilesise dhe gjithashtu pergjigje ne kohe per cdo defect. Ne rast defektesh kompania eshte pergjegjese per mirembajtjen ne eficence te kesaj lidhjeje. Koha maksimale e pergjigjes ndaj defekteve te mundshme, pra koha maksimale gjate se ciles do te kryhet percaktimi I problemit dhe do te vendoset afati i perafert i zgjidhjes se tij eshte 30min.

Ofrimi i sherbimit internet dhe atij te transmetimit te te dhenave duhet te kryhen Brenda nje afati kohor jo me shume se 7 dite pas dates se lidhjes se kontrates.

Koha maksimale e zgjidhjes se problemit , nuk duhet te jete me shume se 180min.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga komisioni i perlllogaritjes se fondit limit dhe do te bashkengjiten dokumentave te tenderit ne SPE.

Njesia e prokurimit
